

## Konferenca e 2-të Ndërkombëtare Studentore



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", zhvilloi me sukses Konferencën e 2-të Ndërkombëtare Studentore "Sfidat e gjeneratave të reja për një të ardhme të qëndrueshme" Rektori i Universitetit Prof.dr. Skender Topi, në fjalën e tij përshëndetëse, shprehu vlerësimin për rëndësinë e angazhimit studentor, duke e konsideruar këtë konferencë si platformën e duhur për të promovuar talentin e studentëve dhe për të krijuar një debat të hapur mbi temat që janë më të rëndësishme për ta. Në kuadër të kësaj konference u zhvillua edhe Konkursi Studentor i Punimeve Artistike dhe Artizanale, ku nuk munguan as çmimet për punimin më të mirë. Në këtë konferencë morën pjesë dhe përshëndetën Ministrija e Arsimit dhe Sportit, Prof. dr. Evis Kushi, Ministrija e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Znj. Bora Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë së Elbasanit, Z. Gledian Llatja, Kryetari i Bashkisë Maltepe, Stamboll, Z. Ali Kiliç, si dhe drejtoresha e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Znj. Marsida Hyseni. Kjo konferencë, e organizuar nga Universiteti i Elbasanit, tregoi rritjen e rëndësishme të interesit të studentëve për të eksploruar fushat e shkencës dhe të krijojnë rrjetet e tyre të kontakteve në nivel ndërkombëtar, si dhe duke prezantuar punimet e tyre origjinale, duke u angazhuar në diskutime të frytshme dhe ndërveprim me kolegët e tyre.



# DITARI MUJOR

Maj 2023

## Java e 2-të Ndërkombëtare "Kultura dhe Komunikimi"



Universiteti i Elbasanit përfundon me sukses Javën e 2-të Ndërkombëtare "Kultura dhe Komunikimi" në kuadër të programit Erasmus +. Gjatë datave 8-12 Maj në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvilluan një sërë aktivitete në kuadër të Javës Ndërkombëtare, ku pjesëmarrës nga universitetet partnere mundën të njihnin nga afër universitetin dhe qytetin e Elbasanit, të shkëmbejnë njohuri dhe përvoja, si dhe të ndanin praktikën më të mirë. Në këtë javë të veçantë, pjesëmarrësit u angazhuan në aktivitete të ndryshme si, seminare, ture kulturore, pjesëmarrje në Panairin UNIEL, ku mundën të njihnin nga afër traditën, gjuhën, historinë dhe kulturën shqiptare, si dhe të prezantohen me fakultetet, personelin dhe studentët tanë. Ndërkombëtarizimi është një element themelor i misionit të Universitetit të Elbasanit dhe angazhimi i tij në përcaktimin e arsimit të lartë sipas standardeve ndërkombëtare. Përmes këtij përkushtimi, universiteti siguron një mjedis të pasur akademik dhe shkencor, i cili kontribuon në formimin e studentëve dhe zhvillimin e një shoqërie të hapur ndaj botës.

### 10 Maji "Dita Kombëtare e Drejtësisë"



Në kuadër të 10 Majit "Ditës Kombëtare të Drejtësisë", Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan kanë organizuar një tryezë diskutimi mbi "Sfidat e Drejtësisë Shqiptare nga Kanuni i Zhurisë deri te Reforma në Drejtësi në Kuadër të Proceseve Integruese". Rektori i Universitetit të Elbasanit Prof.dr. Skender Topi, në fjalën e tij, shprehu falenderimin për pjesëmarrjen e gjerë të personaliteteve të larta të fushës së drejtësisë, gjyqësorit, studiues të së drejtës, komuniteteve fetare, kolegëve dhe studentëve. Ai, theksoi rëndësinë e zhvillimit të takimeve të tilla në kuadër të marrëveshjeve të frytshme, të cilat mundësojnë zhvillimin institucional, kontribuojnë në komunitet dhe në përgatitjen e studentëve që zhvillojnë praktikën pranë këtyre institucioneve. Në këtë takim referuan Z. Kreshnik Ajazi, Kreu i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Elbasan, Prof. Dr. Artan Hoxha, Rektor i Universitetit të Tiranës, Z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Z. Alfred Balla, Kryetar i Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Znj. Matilda Fetahu, Kryetare e

Gjykatës Elbasan, Z. Ilir Proda, Drejtor i Policisë së Qarkut Elbasan, Prof. Asoc. Dr. Imelda Sejdiu, Dekane e Fakultetit Ekonomik, Prof. Asoc. Dr. Rezarta Tahiraj, Përgjegjëse e Qendrës në Drejtësi dhe Ekonomi dhe Prof. Asoc. Dr. Arbër Gjeta, Drejtues i Katedrës "Jean Monnet", EEAABAC. Në përfundim të takimit, referuesit diskutuan rreth temave të trajtuara dhe i'u përgjigjen pyetjeve të të pranishmëve.

### Kongresi i Dytë Ndërkombëtar në FSHMT



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", organizoi Kongresin e Dytë Ndërkombëtar "Trendet e fundit në kërkimin biomjekësor, gjendja aktuale e kërkimit biomjekësor në zonën e Adriatikut". Ky kongres ofron një platformë të veçantë ku kërkues, mjekë, ekspertë, profesionistë të fushës nga vendi e bota, u mblodhën për të ndarë eksperiencën, zbulimet dhe sfidat e fushës së kërkimit biomjekësor në zonën e Adriatikut. Në fjalën e tij përshëndetëse, Rektori i Universitetit, Prof. dr. Skender Topi, shprehu falënderimin e tij ndaj të gjithë pjesëmarrësve dhe organizatorëve të këtij kongresi dhe vlerësoi arritjet e deritanishme në fushën e biomjekësisë. Gjatë tri ditëve të këtij kongresi, u prezantuan projekte inovative, kërkime dhe vëzhgimet e fundit për të nxitur kështu bashkëpunime të reja, si dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së njerëzve në këtë rajon.

### Leksion i hapur në Universitetin e Elbasanit



Leksion i hapur në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" mbi librin "Giovanni Falcone. Një hero i vetmuar", me prezencën e shqipëruar Magj. Engert Pëllumbi Z. Pëllumbi në leksionin e hapur me studentë, lektorë, gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë, u fokusua mbi jetën e veprën e Giovanni Falcone dhe rëndësinë e luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar si një nga objektivat kryesor të Shqipërisë në proceset integruese.